

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI****VENDIM****Nr. 182, Datë 10.11.2017****MBI****MIRATIMIN E METODOLOGJISË SË LLOGARITJES SË TARIFAVE TË
OPERATORIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 19 gërma “b”, nenit 21 të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; VKM nr. 519, datë 13.07.2016 “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”, si dhe në zbatim të nenit 26 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s” miratuar me Vendimin nr. 96 datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 10.11.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, për miratimin e “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes të Energjisë Elektrike”,

Konstatoi se,

- Me konsulencën e USAID u hartua drafti i metodologjisë së llogaritjes së tarifave të operatorit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike.
- Me Vendimin Nr. 156, datë 28.09.2017, Bordi i ERE-s vendosi fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe metodologjisë së llogaritjes së tarifave të operatorit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike.
- ERE me shkresën Nr. 650 Prot., datë 04.10.2017 ka njoftuar të gjitha palët e interesuara, si OSHEE sh.a; MIE; Autoriteti i Konkurrencës; Avokati i Popullit; Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve; Shoqata e Mbrojtjes së Konsumatorit Shqiptar; Shoqata e Konsumatorit Shqiptar; Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë; Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë; Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë dhe Konfindustria; AAES; AREA; FIAA; ACERC dhe Shoqata e Prodhuesve të vegjel të Energjisë Elektrike) dhe u ka kërkuar atyre që brenda datës 12.10. 2017 të shprehin komentet e tyre mbi draftin tashmë të publikuar në faqen e internetit të ERE-s.
- Me shkresën nr. 100/48 Prot., datë 02.10.2017 ERE, nëpërmjet botimit të njoftimit në shtypin e shkruar ka ftuar të shprehin opinionet dhe komentet e tyre me shkrim gjithë personat, Shoqatat dhe institucionet që mendohet se kanë interes për këtë vendimarrje brenda 15 ditëve nga dita e publikimit të njoftimit.
- Në përfundim të afatit nuk rezultoi asnjë koment mbi këtë metodologji.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

- 1 Të miratojë “Metodologjinë e llogaritjes së tarifave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes të energjisë elektrike.” (Bashkëlidhur)
- 2 Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë të interesuarit për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

Kryetari
Petrit AHMETI